

FJALA E DEPUTETIT EDUARD NDRECA

E HËNË 30 MAJ 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Fort të nderuar qytetarë,

Pas përfundimit të dy raundeve të para për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 87, pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 109, pika 3 të Rregullores së Kuvendit, në datën 24.5.2022 u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila, me vendimin nr.12, caktoi datën 30.5.2022 dhe orën 10:00 për zhvillimin e raundit të tretë të votimit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Sipas këtij vendimi, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut do të mbledhet në datën 30.5.2022, në orën 09:00 dhe do të paraqiste në Kuvend raportin e tij. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut u mbledh sot, në datën 30 maj 2022, në orën 09:00, sipas afateve të përcaktuara nga Konferenca e Kryetarëve dhe bazuar në Rregulloren e Kuvendit, për shqyrtimin e kandidaturave të mundshme të depozituara në Kuvend. Komisioni konstatoi se deri në afatin e përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve për zhvillimin e raundit të tretë në Kuvend nuk është depozituar asnjë kandidaturë për President.

Në këto kushte, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në zbatim të nenit 87, pika 2 të Kushtetutës, që përcakton se secili nga votimet e tjera zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga përfundimi pa sukses i votimit pararendës dhe se votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat, i paraqet raportin seancës plenare të mbledhur sot, në datën 30 maj 2022, sipas përcaktimeve ligjore, me qëllim përmbylljen e procedurave për votimin e raundit të tretë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Faleminderit!